

## **AKTI I THEMELIMIT**

**&**

## **STATUTI I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

### **“LABËRIA SPORT KLUB” SHPK**

Në bazë të ligjit 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”, i ndryshuar (këtu e në vijim i referuar si LSHT), nënshkruesi i këtij dokumenti, vendosi si më poshtë vijon:

#### **KAPITULLI I**

#### **DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

##### **Neni 1 Baza ligjore**

1. Hartimi i Aktit të Themelimit dhe Statutit bazohet dhe respekton kërkesat e ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”, i ndryshuar dhe legjislacionit civil në Shqipëri.
2. Dispozitat e Statutit kanë karakter të detyrueshëm dhe rregullojnë marrëdhëniet e Shoqërisë me Ortakët dhe organet e saj, si dhe marrëdhëniet mes Ortakëve. Çështjet që nuk parashikohen shprehimisht në këtë dokument, rregullohen sipas dispozitave përkatëse të legjislacionit shqiptar.

##### **Neni 2 Përkufizime**

1. Në këtë dokument, nëse nuk përcaktohet ndryshe, termat e mëposhtme kanë këto kuptime:
  - a) “**Shoqëria**” nënkuption Shoqërinë tregtare të themeluar sipas këtij dokumenti, me emrin e përcaktuar në nenin 4 të këtij Statuti dhe të ndryshuar sipas rastit, në përputhje me kërkesat e Statutit dhe legjislacionit të zbatueshëm në fuqi;
  - b) “**Statut**” nënkuption Statutin e Shoqërisë;
  - c) “**Ortak(ët)**” sipas rastit, themeluesit e Shoqërisë ose personat fizikë dhe/ose juridikë që zoterojnë kuotat e Shoqërisë në përputhje me kërkesat e këtij Statuti;
  - d) “**Person**” është çdo person fizik apo juridik;
2. Në këtë Statut, me përjashtim të rastit kur sipas kontekstit të dispozitës përkatëse rezulton ndryshe, shprehjet në numrin njëjës përfshijnë ato në numrin shumës dhe anasjelltas, dhe gjinia mashkullore nënkuption atë femërore dhe anasjelltas.

### **Neni 3 Komunikimet**

1. Të gjitha njoftimet dhe/ose komunikimet që Shoqëria i drejton Ortakëve sipas këtij Statuti, do të bëhen me shkrim dhe do të konsiderohen të kryera në mënyrë të rregullt kur u dërgohen Ortakëve në adresat e deklaruara prej tyre pranë Administratorit (ëve) të Shoqërisë, duke përfshirë dhe komunikimet me mjete elektronike, nëse këto të fundit garantojnë konfirmimin e marrjes dhe sigurinë e komunikimit.
2. Të gjitha njoftimet dhe/ose komunikimet e dërguara sipas paragrafit të mësipërm, do të konsiderohen rregullisht të marra nga Ortaku në datën më të hershme midis i) datës së marrjes efektive nga Ortaku; ii) datës së pranimit apo refuzimit të shënuar në njoftimin e marrjes nëse dërgohet me postë të regjistruar; ose iii) brenda 72 orësh nga dorëzimi pranë një shërbimi të shpejtë postar të njohur ndërkontëtarisht.

### **KAPITULLI II THEMELIMI**

#### **Neni 4 Data e themelimit, Themeluesit dhe Emri**

1. Sot, më datë 28/06/2024, unë themeluesi krijoj një Shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar.
2. Emri i Shoqërisë është "LABËRIA SPORT KLUB" Shpk (në vijim referuar si "Shoqëria").
3. Themeluesi i Shoqërisë është:

**Znj. Sibora Lalaj**, shtetase shqiptare, e bija e Gencit, lindur në Vlorë, më datë 6 Shkurt, 1993, mbajtëse e kartës së identitetit me numër personal J35206094P, rezidente në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me adresë 130 Mimosa Drive, Roslyn, NY 11576, madhore dhe me zotësi të plotë për të vepruar.

#### **Neni 5 Objekti**

1. Objekti i Shoqërisë është kryerja e të gjitha veprimtarive që një Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar mund të ushtrojë sipas ligjit shqiptar, brenda dhe jashtë territorit të saj, duke përfshirë, por pa u kufizuar në:  
Aktivitete sportive në disiplinën e futbollit;
2. Shoqëria do të ushtrojë çdo aktivitet tjetër të ligjshëm që është i nevojshëm për përbushjen e objektit të veprimtarisë së saj.

#### **Neni 6 Selia**

1. Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Kompleksi Laberia, pranë Green Park Nartë, Vlorë, Shqipëri. Kjo do të jetë edhe adresa e shoqërisë për qëllime komunikimi
2. Shoqëria gjatë ushtrimit të aktivitetit të saj ka të drejtë të hapë degë apo filiale, zyra përfaqësimi, në të gjithë vendin, brenda dhe jashtë territorit të saj.

**Neni 7**  
**Kohëzgjatja**

Shoqëria krijohet pa një afat të caktuar.

**Neni 8**  
**Marka tregtare**

1. Shoqëria do të ketë markën e saj tregtare, e cila krijohet dhe regjistrohet pranë organeve kompetente, si dhe mbrohet në përputhje me legjislacionin në fuqi për markat tregtare.

**Neni 9**  
**Të ndryshme**

1. Kjo Shoqëri mund të ndryshojë emrin e saj, selinë, objektin e aktivitetit, etj., sipas vendimeve të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me parashikimet Statutit dhe LSHT-së, dhe t'i regjistrojë këto të dhëna vullnetarisht pranë organeve kompetente sipas legjislacionit në fuqi.

**KAPITULLI III**  
**Neni 10**  
**KAPITALI**

1. Kapitali i nënshkruar i Shoqërisë është 100 Lekë (njëqind). Kontributi i themeluesit në kapitalin e regjistruar është si vijon:  
Sibora Lalaj, kontribute në para në vlerë 100 lekë (njëqind), totali i kontributeve 100 Lekë (njëqind);
2. Kapitali i regjistruar është plotësisht i paguar, dhe përbëhet në momentin e themelimit nga 1 kuotë, e zotëruar nga Ortaku i vetëm në përputhje me nenin 11 dhe shtojcën 1 bashkëlidhur këtij Statuti.
3. Ndryshimi i numrit të kuotave të shoqërisë në përputhje me numrin e ortakëve të ardhshëm dhe transferimet e kuotave ndërmjet tyre, bëhet sipas parashikimeve të LSHT-së.

**Neni 11**  
**Ortakët**

1. Ortakët e Shoqërisë janë personat që kanë përfituar kuotën e tyre në Shoqëri në përputhje me kontributin e tyre. Kapitali i regjistruar i Shoqërisë ndahet midis Ortakëve në kuota me vlerë në përputhje me kontributet përkatëse në kapital. Kontributi mund të jetë në para ose natyrë (pasuri e paluajtshme apo të drejta të Ortakëve).
2. Ortaku i vetëm aktual i Shoqërisë dhe kontributi përkatës paraqitet në shtojcën 1 të këtij Statuti.

## **Neni 12**

### **Kontributet dhe detyrimet e ortakeve**

1. Aktiviteti dhe veprimtaria e Shoqërisë "LABËRIA SPORT KLUB" shpk, për natyrën dhe qëllimin për të cilin është themeluar, financohet dhe mirëmbahet nga kontributet financiare vjetore të ortakëve, në përputhje me kuotat përkatëse që zoterojnë në Shoqëri, duke përfshirë cdo ortak të ri që mund t'i shtohet asaj. Asambleja e përgjithshme e ortakëve miraton buxhetin vjetor të financimit të shoqërisë dhe periodicitetin e pagimit të kontributit financiar përkatës të secilit ortak.
2. Ortakët janë të detyruar të përbushin detyrimin për pagimin e kontributeve sipas pikës 1 të këtij neni. Mbarëvajtja dhe vazhdimësia e aktivitetit të shoqërisë, është tërësisht i varur nga kontributi financiar vjetor i ortakëve. Për këtë arsy, mospagimi pjesor apo tërësor i kontributit, do të konsiderohet mospërmbushje thelbësore e detyrimeve ndaj shoqërisë dhe dëmtim i interesave të saj, dhe si e tillë përbën shkak të mjaftueshëm dhe legjitim për largimin e ortakut nga shoqëria dhe anullimin e kuotave të tij, sipas parashikimeve të nenit 13 më poshtë.
3. Në rastet e mospërmbushjes së detyrimeve të parashikuara në pikën 1 dhe 2 të këtij neni, ortakët e shoqërisë janë të detyruar të marrin masat e duhura për të njoftuar dhe paralajmëruar ortakun/ortaket për këtë mospërmbushje dhe pasojat përkatëse, 2 (dy) herë me distancë kohore 30 ditë.
4. Ortakja Sibora Lalaj, ngarkohet me detyren e drejtimit politik dhe strategjik të shoqërisë, monitorimin e vazhdueshëm të aktivitetit të saj, si edhe sigurimin e mbarëvajtjes dhe suksesit të të gjithë veprimtarisë së shoqërisë.

## **Neni 13**

### **Anullimi i kuotave**

1. Shoqëria ka të drejtë të anullojë kuotën/kuotat, në rastet kur:
  - Ortaku shkel detyrimin e përcaktuar në pikën 1 dhe 2 të nenit 12 të Statutit, duke mos shlyer detyrimin e pagimit të kontributit financiar, 2 herë radhazi ose 2 herë brenda vitit financiar;
  - Sjellja e ortakut është pengesë në kryerjen e aktivitetit dhe detyrave statutore të shoqërisë;
  - Sjellja e ortakut bie ndesh me normat e etikës dhe moralit dhe dëmton imazhin dhe kredibilitetin e shoqërisë në raport me palë të treta.
2. Në rast të konstatimit të një prej rasteve të mësipërme, ortaku paralajmërohet me shkrim 2 herë radhazi, duke i lënë afat për korrigjin e shkeljes dhe informuar për pasojat përkatëse nëse kjo nuk ndodh.
3. Nëse ortaku nuk korrigjon shkeljen edhe pas masave të marra sipas pikës 2, ai është i detyruar të pranojë anullimin e kuotës së tij, nëpërmjet komunikimit shkresor drejtuar shoqërisë. Në këtë rast shoqëria nuk ka detyrim të marrë vendime të mëtejshme, përvecse të ndjekë procedurat sipas pikës 5 më poshtë.
4. Nëse ortaku refuzon të pranojë ose nuk shprehet mbi anullimin e kuotës, shoqëria merr vendim për anullimin e saj dhe ia komunikon atë ortakut. Ortaku humbet të drejtën të kundërshtojë këtë vendim të shoqërisë në të ardhmen, duke patur parasysh se mospërmbushja e detyrimeve edhe pas paralajmërimeve, prezumon vullnetin e tij për largimin nga shoqëria.
5. Shoqëria merr masat procedurale të nevojshme për reflektimin e ndryshimit të numrit të kuotave në dokumentet dhe organet përkatëse.

**Neni 14**  
**Zmadhimi dhe zvogëlimi**

1. Kapitali i regjistruar mund të zmadhohet ose të zvogëlohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme sipas shumicës së parashikuar nga dispozitat përkatëse të LSHT-së.
2. Zmadhimi i kapitalit mund të vendoset kur e kërkojnë interesat e Shoqërisë duke ndryshuar përkatësisht vlerën e kuotave të Ortakëve. Zmadhimi i kapitalit mund të realizohet me anë të përfshirjes së fitimeve ose të rezervave në kapital ose me anë të kontributave të reja.
3. Kuotat e Ortakëve do të rriten/zvogëlohen përkatësisht sipas përcaktiveve në vendimin e Asambesë për zmadhimin/zvogëlimin e kapitalit.
4. Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek Ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

**Neni 15**  
**Fitimi dhe kalimi I kuotave**

1. Kuotat e kapitalit të Shoqërisë dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo të kalohen nëpërmjet:
  - a) Kontributit në kapitalin e Shoqërisë;
  - b) Shitblerjes;
  - c) Trashëgimisë;
  - d) Dhurimit;
  - e) Çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj.
2. Kuotat e kapitalit në Shoqëri janë lirisht të transferueshme ndërmjet Ortakëve.
3. Në çdo rast tjetër të transferimit të pjesëve të kapitalit jashtë strukturës së Ortakërisë, Ortakët gjëzojnë të drejtën e parablerjes. Ortaku i cili dëshiron të transferojë kuotën e tij do të njoftojë Ortakët e tjerë nëpërmjet një njoftimi me shkrim me kthim përgjigje, i cili duhet të përcaktojë synimin për shitjen, çmimin, kushtet, modalitetet, emrin e blerësit dhe afatet e transferimit. E drejta e parablerjes i referohet të gjitha pjesëve të kapitalit të ofruar për shitje.
4. Ortakët e Shoqërisë njoftojnë qëllimin e tyre për të ushtruar të drejtën e parablerjes brenda 30 ditëve nga marrja e njoftimit të mësipërm. Në rast se Ortakët nuk përgjigjen në afatin e caktuar prezumohen se kanë hequr dorë nga e drejta e tyre e parablerjes. Në këtë rast Ortaku që kërkon të largohet ka të drejtë të transferojë tek të tretët kuotën e tij.
5. Në rast se ushtrohet e drejta e parablerjes, pjesët e kapitalit mund t'i transferohen të tretëve plotësisht apo pjesërisht, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme sipas shumicës së përcaktuar në dispozitat përkatëse të LSHT-së.

**KAPITULLI IV**  
**ORGANET VENDIMMARRËSE DHE DREJTUESE**

**Neni 16**  
**Organi vendimmarrës**

1. Organi i vetëm vendimmarrës i Shoqërisë është Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve.

2. Asambleja e Përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve lidhur me çështjet si më poshtë:
  - a) Përcaktimin e politikave tregtare të Shoqërisë;
  - b) Ndryshimet e Statutit;
  - c) Emërimin e shkarkimin e administratorit/ëve;
  - d) Emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
  - e) Përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat c) dhe d) të kësaj pike;
  - f) Mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - g) Zmadhimin dhe zgjedhjen e kapitalit;
  - h) Pjesëtimin e kuotave dhe anullimin e tyre;
  - i) Përfaqësimin e Shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
  - j) Riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë;
  - k) Miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të Asamblesë;
  - l) Çështje të tjera të parashikuara nga LSHT apo Statuti.
3. Ortaku mund të përfaqësohet në Asamblenë e Përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një Ortak tjetër apo nga një person i tretë.
4. Administratori i Shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i Ortakëve në Asamblenë e Përgjithshme.
5. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.
6. Votimi në asamblenë e përgjithshme mund të bëhet me shkresë, apo me mjete elektronike, në përputhje me LSHT-në.

### **Neni 17 Mënyra e thirrjes së Asamblesë së Përgjithshme**

1. Asambleja e Përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë Ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpëra datës së parashikuar për mbledhjen e e Asamblesë.
2. Kur Asambleja e Përgjithshme nuk është thirrur sipas paragrafit të mësipërm të këtij nenit, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë Ortakët janë dakord për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

### **Neni 18 Kuorumi**

1. Në rastin e marjes së vendimeve që kërkojnë shumicë të zakonshme, Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë Ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.
2. Në rastin kur Asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas dispozitave të LSHT-së dhe këtij Statuti, ajo mund të marrë vendime të



vlefshme vetëm nëse Ortakët që zoterojnë më shumë se gjysmën e numrit total të kuotave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo me mjete elektronike, sipas parashikimit të pikës 3 të nenit 88 të LSHT-së.

- Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumi të përmendur në paragrafin e mësipërm të këtij neni, Asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njejtin rend dite.

### **Neni 19 Marrja e vendimeve**

- Asambleja e Përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të Ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e Statutit, zmadhimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë. Për të gjitha çështjet e tjera të përcaktuara në nenin 14 të këtij Statuti, Asambleja e Përgjithshme vendos me shumicën e votave të Ortakëve pjesëmarrës si dhe referuar kuorumi të parashikuar.
- Vendimet e asamblesë nënshkruhen nga ortakët apo persona të autorizuar prej tyre, të cilët marrin pjesë fizikisht në mbledhje. Votimet me shkrim apo mjete elektronike, i bashkëngjiten vendimit, janë pjesë integrale e saj dhe nuk nevojitet nënshkrimi nga ortakët që kanë votuar në këtë mënyrë.

### **Neni 20 Administrimi**

- Shoqëria administrohet nga 1 Administrator, i cili qëndron në detyrë deri në revokimin, dorëheqjen ose përfundimin e afatit të caktuar nga Asambleja në Aktin e emërimit.
- Administratori caktohet në Statutin e Shoqërisë dhe më pas emërohet nga vendimet e Asamblesë së Ortakëve. Administratori qëndron në detyrë për një periudhë prej 1 viti me të drejtë riemërimi nëpërmjet vendimit të Asamblesë së Ortakëve.
- Administratori ka të drejtë dhe detyrohet të:
  - Kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të Shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme;
  - Përfaqësojë Shoqërinë tregtare;
  - Kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe librave kontabël të Shoqërisë;
  - Përgatisë dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë së Shoqërisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, lparaqet këto dokumente përpara Asamblesë së Përgjithshme përmiratim;
  - Krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e Shoqërisë;
  - Kryejë regjistrimet dhe të dërgojë të dhënrat e detyrueshme, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;

- g) Raportojë përpara Asamblesë së Përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e Shoqërisë;
  - h) Të nënshkruajë kontrata të ndryshme për të realizuar qëllimin e objektit të veprimtarisë, duke përfshirë, por pa u kufizuar në:
    - i. Nënshkrimin e kontratave me punonjës të shoqërisë;
    - ii. Nënshkrimin e kontratave të shitblerjes së futbollistëve që do të përfshihen në skuadrat e krijuara për realizimin e objektit të shoqërisë;
    - iii. Nënshkrimin e kontratave të shërbimit sipas nevojave të shoqërisë.
  - i) Kryejë detyra të tjera të përcaktuara me ligj dhe në këtë Statut;
  - j) Thërrasë Asamblenë e Përgjithshme, në rastet kur:
    - i. Sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton se ekziston rreziku që aktivet e Shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve;
    - ii. Shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të Shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të çertifikuara.
4. Asambleja e Përgjithshme mund të shkarkojë Administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me Shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.
5. **Administrator i Shoqërisë është znj. Liljana Meço, shtetase shqiptare, mbajtëse e kartës së identitetit F26004035I.** Specimeni i nënshkrimit të administratorit është sipas përcaktimit në shtojcën 2 bashkëlidhur Statutit.

### Neni 21 Përgjegjësitë e administratorit

1. Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj Shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të Statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të Shoqërisë.
2. Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga Asambleja që i sjellin dëm Shoqërisë, i ngarkohen administratorit apo Ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë solidare apo individuale, sipas rastit, pasojat përkatëse.
3. Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 dhe 18 të LSHT-së, Administratori detyrohet:
  - a) Të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në Statut, në mirëbesim e në interesin me të mirë të Shoqërisë në tërësi;
  - b) Tshtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në Statut për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
  - c) Të vlerësojë me përgjegjësi çështjet për të cilat merr vendim;
  - d) Të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personal me ata të Shoqërisë;
  - e) Të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizëm dhe kujdesin e nevojshëm.

4. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjet ndaj Shoqërisë për çdo veprim apo mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e Shoqërisë, me përjashtim të rasteve, kur në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi apo mosveprimi është kryer në mirëbesim. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standarde profesionale të parashikuara, është l deryruar t'i dëmshpërblejë Shoqërisë dëmet që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ai apo personat e lidhur me të kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkua.
5. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë Shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e LSHT, kryen veprimet e mëposhtme:
  - a) U kthen Ortakëve kontributet;
  - b) U paguan Ortakëve interesa apo dividentë;
  - c) U shpérndan aktivet Shoqërisë;
  - d) Lejon që Shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që Shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
  - e) Jep kredi.

### **Neni 22 Marrëdhëni e punës**

1. Marrëdhëni e punës rregullohen nëpërmjet kontratës së punës dhe legjisacionit të punës në fuqi. Shoqëria merr përsipër të respektojë rregullat në fuqi të punësimit dhe të punësuarit janë të detyruar të respektojnë Statutin e kësaj Shoqërie dhe rregullat e brendshme të saj. Të punësuarit duhet të përgjigjen për dëmet që i shkaktojnë kësaj Shoqërie nga veprimet ose mosveprimet e tyre sipas ligjit.

### **Neni 23 Konfidencialiteti**

1. Konsiderohen konfidenciale dhe nuk lejohet të bëhen publike nga Administratori i Shoqërisë, përbajtja e tyre për të tretët e të gjitha akteve dhe dokumenteve që janë përcaktuar si të tilla.

### **KAPITULLI V VITI FINANCIAR – EKSPERTËT**

#### **Neni 24 Viti finanziar**

1. Viti finanziar i Shoqërisë fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor. Përjashtimisht, viti i parë finanziar fillon nga data e regjistrimit të Shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbyllt më 31 Dhjetor të të njëjtë vit.

#### **Neni 25 Ekspertët**

1. Në rast se kërkohet nga ligji apo vendoset nga Asambleja e Përgjithshme, kontrolli i bilanceve dhe librave kontabël të Shoqërisë mund t'i besohet një eksperti kontabël të autorizuar, i cili mandatohet në vendimin e emërimit. Eksperti ka për detyrëtë kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimitarës ekonomiko-tregtare të Shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga Ortakët.
2. Në përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të vitit finanziar si dhe për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar t'ia paraqesë e dorëzojë në kohë Ortakëve për t'l shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendmore që ka.

## **KAPITULLI VI PRISHJA, RIORGANIZIMI I SHOQËRISË**

### **Neni 26 Prishja dhe likujdimi**

1. Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar prishet:
  - f) Me vendim të asamblesë së Përgjithshme;
  - g) Me hapjen e procedurave të falimentimit;
  - h) Nëse nuk ka kryer veprimitari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimitarës në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligji nr. 9723 datë 03.05.2007 "Për Regjistrimin e Biznesit", i ndryshuar;
  - i) Me vendim të gjykatës;
  - j) Për arsyen e tjera të parashikuara në LSHT.
2. Në rast se Shoqëria shpërndahet për çdo lloj arsyje, Asambleja e Ortakëve përcakton mënyrën e likujdimit, emëron një ose më tepër likujdues dhe përgatit të gjitha dokumentet e nevojshme për çregjistrimin e saj nga Qendra Kombëtare e Biznesit. Në rast se Ortakët nuk marrin një vendim për emërimin e likujduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'l drejtohet gjykatës për të caktuar një likujdues.

### **Neni 27 Riorganizimi i Shoqërisë, Bashkimi, Ndarja**

1. Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas vendimit të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, në përputhje me dispozitat e parashikuara në Pjesën IX të LSHT-së.

### **Neni 28 Ligji I zbatueshëm**

1. Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë Statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar në fuqi.

### **Neni 29**

## **Mosmarrëveshjet**

1. Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me interpretimin dhe/ose zbatimin e Akitit të Themelimit dhe Statutit, si edhe ato që mund të lindin në përgjithësi midis Ortakëve (përvec atyre personale apo jashtë Shoqërisë) ose midis një apo më shumë Ortakëve dhe Shoqërisë, do të zgjidhen në mënyrë miqësore dhe do të diskutohen në mënyrë të drejtpërdrejtë ndërmjet palëve të interesuara.
2. Në rast se mosmarrëveshjet nuk zgjidhen në mënyrë miqësore midis Ortakëve, atëherë komptente për zgjidhjen e tyre do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë.

## **THEMELUESIT**

### **SIBORA LALAJ**



Sibora Lalaj

**SHTOJCA 1  
(ORTAKËT E SHOQËRISË)**

Znj. **Sibora Lalaj**, shtetase shqiptare, e bija e Gencit, lindur në Vlorë, më datë 6 Shkurt, 1993, mbajtëse e kartës së identitetit me numër personal J35206094P, rezidente në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me adresë 130 Mimosa Drive, Roslyn, NY 11576, USA, zotëruese e një kuote me vlerë 100 Lekë (njëqind), që përfaqëson 100 (njëqind) për qind të kapitalit të Shoqërisë.

**Emer, Mbiemer, Firme**

*Sibora Lalaj,  
Sibora Lalaj*